



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 62/2012

Prishtinë, më 04.05.2012, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrëse të tjerë: Frymëzim Isufaj, Nazmi Zenelaj dhe Marcelë Restelica – MZHE; Ukë Gashi ZPRK; Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Shkamb Qavdarbasha- INDEP; Florije Mehmeti - KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës: Themelimi i grupit të punës për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, sepse e kemi paraparë në Plan të punës së Komisionit për këtë vit.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

2. Shqyrtimi i Raportit me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike

Kryetari – Ia dha fjalën raportueses së grupit të punës, znj.Sahatqija që të paraqesë Raportin me propozimamendamente.

Teuta Sahaqija – Theksoi se grupi i punës në muajin e kaluar ka mbajtur një dëgjim publik dhe një punëtori ku ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe në masë të madhe i kemi harmonizuar disa qëndrime, si: kush do të hartojë dhe miratojë Planin kombëtar të radio-frekuencave; kompetenca e legjislacionit sekondar; vendosja e emrave dhe adresave tek seritë alfa-numerike, serive të numrave etj. si dhe çështja e mandatit të Bordit dhe kompetencave të tij. Pastaj propozoi për shqyrtim raportin me 75 propozimamendamente.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me amendamentet e propozuara, me përjashtim të amendamenteve si në vijim: amendamenti 55, 65, 66 dhe 68, të hiqen si të panevojshme, si dhe u bë ndryshimi dhe plotësimi i amendamenteve 61 dhe 62. Kështu, në fund të debatit, u miratuan 71 amendamente dhe u proceduan tek komisionet e përhershme.

Pas debatit, Komisioni nxori

Konkluzion

Miratoi Raportin me propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike me ndryshimet e cekura.

3. Themelimi i grupit të punës për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari –Propozoi që të shtohet kjo pikë e rendit të ditës dhe tha se ka qenë propozimi i grupit të punës që gjatë monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale vitin e kaluar, që të pësojë ndryshime ky Ligj dhe Komisioni të marrë iniciativën për draftimin e tij. Po ashtu, ai ua kujtoi deputetëve se kjo çështje është e paraqitur edhe në plan të punës së Komisionit.

Komisioni, pas debatit nxori unanimisht këtë

VENDIM

- 1. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri do të hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale;*
- 2. Themelohet grupi i punës në këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, Zenun Pajaziti, Fikrim Damka, Hashim Deshishku dhe Visar Ymeri;*

3. *Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij Projektligji;*
4. *Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;*
5. *Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësine koordinuese të Komisionit, do të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari – I njoftoi deputetët se ka informacione shtesë nga Qeveria në lidhje me emërimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së.

Visar Ymeri – Njoftoi Komisionin se Kryesia e ka paraparë këtë çështje në rend dite dhe duhet të vepohet para se ajo të vendoset për seancë.

Pas debatit, Komisioni mori qëndrim që t'i paraqitet një kërkesë Kryesisë së Kuvendit si vijon: Në seancën e radhës së Kuvendit (dt.10.05.2012), të mos përfshihet në rend dite: “Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit